

PROCESVERBAL
nga seanca e 14-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuele
mbajtur më 08.04.2024

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë nëpërmjet lidhjes video-konferencë: Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr.Alma Mashoviq, dr.Metodija Jançeski, Lllazar Trajçev, Zoran Fidanoski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë nëpërmjet lidhjes video-konferencë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Të pranishëm nga Shërbimi Profesional nëpërmjet lidhjes video-konferencë: mr. Dragica Ljubevska, Cvetanka Mitrevska, mr.Magdalena Davidovska Dovleva, Arben Saiti, Maja Damevska, dr.Ivana Stojanovska.

Të pranishmit e tjerë:/

Z. Petrushevski hapi seancën e 14-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele. Seanca filloi në orën 15:30 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri, me 6 vota "pro", miratoi:

RENDIN E DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 13-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 02.04.2024.
2. Propozim-vendim për anulimin e Vendimit PA1 nr.0803-63 datë 04.03.2024 për heqjen e lejes për transmetim në radio të SHTR RADIO ALEKSANDAR MAKEDONSKI Ilija Tanevski Kërçovë SHPKNJ.
3. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike të operatorit SPAJDER SHPKNJ nga Gjevgjelia.
4. Propozim për shqiptim e masës vërejtje publike botuesit të medias së shkruar Kolor Media Plus nga Shkupi.
5. Propozim për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim: Mirëmbajtja parandaluese dhe adaptive e softuerit për sistemin e monitorimit të shërbimit në RA dhe TV dhe mbikëqyrja e ORRPKE-së .

6. Propozim për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik-shërbim: Mirëmbajtja e higjienës në hapësirat e punës së Agjencisë.
7. Propozim për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik - mallra: Material informativ i imët dhe i shpenzuar.
8. Të ndryshme.

Pika 1

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe miratoi njëzëri Procesverbalin e propozuar nga seanca e 13- të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 02.04.2024, me tekstin e propozuar.

Pika 2

Z. Trajçevski shpjegoi Propozimin për miratimin e Vendimit me të cilin do të anulohet Vendimi për heqjen e lejes për radio transmetim të SHTR Radio Aleksandar Makedonski nga Kërçova. Ai shpjegoi se për shkak të mospagesës së kompensimit, përkatësisht faturës për radio transmetim të Radio Aleksandar Makedonski, Këshilli i Agjencisë ia heq lejen këtij transmetuesi. Shkak i heqjes së lejes ka qenë se këtij subjekti juridik i është bllokuar llogaria dhe nuk ka mundur të bëjë pagesën e mjeteve për lejen në llogarinë e ASHMA-së. Pas heqjes së lejes në afatin e përcaktuar ligjor prej 30 ditësh, transmetuesi ka paguar kompensimin, ka paraqitur padi në Gjykatën Administrative për anulimin e Vendimit të Agjencisë, sepse janë mënjeluar arsyet për të cilat është hequr leja dhe që nga sot ka paguar dhe shpenzimet plotësuese që ka pasur Agjencia, për publikimin e Vendimit për heqjen e lejes në dy gazeta ditore dhe në Gazetën Zyrtare të RMV-së. Ai bën të ditur se përveç pagesës së lejes, transmetuesi ka paguar edhe të gjitha shpenzimet e tjera financiare të bëra nga Agjencia për shkak të procedurës së heqjes së lejes.

Këshilli i Agjencisë njëzëri ka miratuar Vendim me të cilin anulohet plotësisht Vendimi i Këshillit të Agjencisë PA1 nr.0803-63 datë 04.03.2024 për heqjen e lejes për radio transmetim të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive (SHTR) RADIO ALEKSANDAR MAKEDONSKI Ilija Tanevski Kërçovë SHPKNJP, PA1 nr.08-102, datë 07.09.2023, për faktin se transmetuesi e ka përmbushur plotësisht detyrimin ligjor për pagesën e kompensimit vjetor për lejen e transmetimit në radio, në pajtim me faturën e dhënë nr. 2024-100-0055 datë 11.01.2024 (nr. ynë ark.0503-232/1 datë 11.01.2024) dhe plotësisht ka paguar shpenzimet që rrjedhin nga procedura e kthimit të lejes.

Z. Petrushevski tha se duhet të informohet edhe Gjykata Administrative që transmetuesi SHTR Radio ALEKSANDAR MAKEDONSKI të mund të punojë lirshëm.

Pika 3

Z. Trajçevski shpjegoi Propozimin për shqiptimin e masës vërejtje publike ndaj operatorit SPAJDER SHPKNJP Gjevgjeli. Ai ka shpjeguar se Shoqëria për veprimtari radiodifuzive SPAJDER SHPKNJP Gjevgjeli, e cila sipas njoftimit të Agjencisë për Komunikime Elektronike mund të kryej veprimtari në territorin e komunës së Gjevgjelisë dhe Bogdancit, me datë 02.04.2024 për shfrytëzuesit e saj ka ritransmetuar shërbimin programor "Planeta", e cila nuk përfshihet në çertifikatën për regjistrim të shërbimeve programore të dhënë nga Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, gjë që është në kundërshtim me nenin 141 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele. Për këto

arsye dhe meqenëse shkelja është kryer për herë të parë këtë vit, propozohet që të shqiptohet masë vërejtje publike.

Këshilli i Agjencisë ka shqyrtuar Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të rregullt programore, nr.11-1772/1 të datës 03.04.2024 dhe ka konstatuar që Shoqërisë për veprimtari radiodifuzive SPAJDER SHPKNJP Gjevgjeli t'i shqiptoj masë vërejtje publike për shkelje të nenit 141 të LSHMAAV dhe në pajtim me pikën 8 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës (Tekst i pastruar) nr.01-4139/1 datë 07.11.2022 e ka udhëzuar menjëherë pas pranimit të Aktvendimit për vërejtje publike të harmonizon punën e saj me LSHMAAV.

Pika 4

Udhëheqësja e Sektorit për Planifikim Strategjik dhe të Drejtat e Autorit, mr. Magdalena Davidovska Dovleva, shpjegoi Propozimin për shqiptimin e masës vërejtje publike të KOLOR MEDIA PLUS SHPK Shkup, botues i "The Economist". Ai ka shpjeguar se me kontrollin e mbikëqyrjes administrative që është bërë në shkurt 2024 është konstatuar se edhe përkundër paralajmërimit të mëhershëm publik, botuesi i medias së shkruar nuk e ka përmbushur plotësisht detyrimin për impresium për publikimin e të gjitha të dhënave të kërkuara në pajtim me Ligjin për Media, por vetëm pjesërisht i ka publikuar të dhënat. Në pajtim me ligjin, nga botuesi është kërkuar të deklarohet dhe është thënë se bëhet fjalë për gabim të paqëllimshëm, duke qenë se mediumi i shtypur botohet një herë në vit dhe se në botimin e ardhshëm do ta përmbush detyrimin ligjor në tërësi.

Këshilli i Agjencisë e shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të kontrollit administrativ, nr.0304-1008/1 të datës 26.02.2024 dhe konstatoi që Shoqërisë për prodhim, tregti dhe shërbime KOLOR MEDIA PLUS SHPK Shkup, botues i "The Economist" t'i shqiptoj masë vërejtje publike për shkelje të nenit 14 paragrafi 1 të Ligjit për media dhe në pajtim me pikën 8 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Teksti i pastruar) nr.01-4139/1 të datës 07.11.2022 që në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të Vendimit për paralajmërim publik të harmonizon punën e saj me LSHMAAV.

Pika 5

Udhëheqësja e Sektorit për Çështje Juridike dhe Furnizim Publik, Cvetanka Mitrevska shpjegoi propozimin për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik – shërbim: mirëmbajtja parandaluese dhe adaptive e softuerit për sistemin e monitorimit të shërbimeve të RA dhe TV dhe mbikëqyrja e ORRPKE. Ajo shpjegoi se ky furnizim është i paraparë në Planin Vjetor për furnizim publik të Agjencisë për vitin 2024. Mjetet janë të parashikuara në Planin Financiar për këtë vit dhe meqenëse kontrata që do të dalë nga kjo procedurë për furnizim publik do të lidhet për një periudhë 2-vjeçare, të njëjtat mjete do të parashihen dhe në planet financiare për vitin në vijim. Sipas shumës së mjeteve të parashikuara, kjo procedurë do të realizohet si procedurë e hapur, në përputhje me dispozitat e Ligjit për furnizim publik për këtë lloj procedure, që do të thotë se shpallja do të publikohet në sistemin elektronik, Gazetën Zyrtare të RMV-së dhe Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.

Z. Trajçev pyeti nëse është e drejtë që në këtë moment të fillohen procedura të tilla për furnizim dhe të miratohen procedura që të mund të publikohen, nga aspekti se është periudhë zgjedhore.

Z. Petrushevski shpjegoi se nëse furnizimi publik është tashmë në Planin vjetor për furnizim publik dhe se realizimi i furnizimit është në pajtim me ligjin. Ai ka shpjeguar se gjatë periudhës zgjedhore nuk mund të plotësohet Plani Vjetor për furnizim publik, por nëse ato tashmë janë miratuar në Planin Vjetor për furnizim publik, nuk ka pengesa ligjore që furnizimi të realizohet normalisht.

Z. Trajçev theksoi se pyetja ka të bëjë më shumë me marrjen e Vendimit për miratimin e furnizimit, edhe drejtori sjell Vendim dhe ata si Këshill e miratojnë të gjithë procedurën, në këtë pjesë nëse është e lejuar në këtë periudhë.

Z. Trajçevski shpjegoi se është e lejuar, sepse nuk mund të realizohet furnizimi nëse nuk fillohet procedura, dhe meqenëse është paraparë në Planin financiar dhe në Planin për furnizim publik, ligjërisht është e lejuar. Ai shpjegoi se kontrata aktuale e mirëmbajtjes së softuerit skadon në qershor dhe kjo periudhë është tashmë optimale për të realizuar këtë furnizim (blerje), për të zgjedhur operator, në mënyrë që të vazhdohet me mirëmbajtjen e sistemit.

Z. Fidanoski, në kuadër të diskutimit, tha se sipas tij, nëse furnizimet janë paraparë në Planin financiar dhe në Planin për furnizim publik, nuk ka asnjë pengesë, edhe pse është periudhë zgjedhore, sepse furnizimi është paraparë më parë dhe në cilën periudhë duhet të realizohet për respektimin e afateve dhe për të patur vazhdimësi në shfrytëzimin e furnizimit publik. Do të ishte problem nëse gjatë kësaj periudhe do të kishte situatë, qoftë edhe nëse është urgjente, që do të duhej të konvertoheshin mjetet financiare, atëherë do të ishte diskutabile (e diskutueshme).

Këshilli i Agjencisë njëzëri dha miratim për zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim: Mirëmbajtja parandaluese dhe adaptive e softuerit për sistemin e monitorimit të shërbimeve në RA dhe TV dhe mbikëqyrje të ORRPKE-së.

Zbatimi i procedurës për furnizim publik për lëndën-shërbim: Mirëmbajtja parandaluese dhe adaptive e softuerit për sistemin e monitorimit të shërbimeve në RA dhe TV dhe mbikëqyrje të ORRPKE-së, është parashikuar dhe është në pajtim me Planin vjetor për furnizim publik për vitin 2024 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale nr. 05-4729/1 datë 22.12.2023, dhe mjetet sigurohen me Planin Financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2024, pra më tej do të sigurohen me Planin Financiar për vitin 2025.

Pika 6

Udhëheqësja e Sektorit për çështje juridike dhe furnizim publik, Cvetanka Mitrevska shpjegoi Propozimin për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim: mirëmbajtja e higjienës në hapësirat e punës së Agjencisë. Ajo ka shpjeguar se ky furnizim është paraparë në Planin vjetor për furnizime publike dhe për këtë arsye po inicohet procedura për realizimin e tij. Ajo shpjegoi se mjetet janë parashikuar në Planin financiar për vitin 2024 dhe se kontrata që do të rezultojë do të lidhet për një periudhë njëvjeçare. Sipas shumës së mjeteve të parashikuara, ky furnizim do të realizohet në pajtim me rregullat për procedurë të hapur të thjeshtuar nga Ligji për Furnizime Publike, që do të thotë se shpallja për këtë furnizim do të publikohet në sistemin elektronik për furnizime publike dhe në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Këshilli i Agjencisë njëzëri dha miratim për zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim: Mirëmbajtja e higjienës në hapësirat e punës së Agjencisë.

Zbatimi i procedurës për furnizim publik për lëndën - shërbim: Mirëmbajtja e higjienës në hapësirat e punës së Agjencisë është parashikuar dhe është në pajtim me Planin vjetor për furnizim publik për vitin 2024 të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale nr.05-4729/1 datë 22.12.2023, ndërsa mjetet sigurohen nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2024.

Pika 7

Udhëheqësja e Sektorit për çështje juridike dhe furnizim publik, Cvetanka Mitrevska, shpjegoi propozimin për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik - mallra: material informativ i imët dhe i shpenzueshëm. Ajo ka shpjeguar se ky furnizim është paraparë edhe në Planin Vjetor për furnizim publik për vitin 2024, se furnizimi është me vlerë të vogël (ulët) dhe do të realizohet në pajtim me rregullat e Ligjit për furnizim publik. Shpallja do të publikohet vetëm në sistemin elektronik për furnizim publik.

Këshilli i Agjencisë njëzëri dha miratim për zbatimin e procedurës për furnizim publik - mallra: material informativ i imët dhe i shpenzuar.

Zbatimi i procedurës për furnizim publik për lëndën - mallra: material informativ i imët dhe i shpenzueshëm, është parashikuar dhe është në pajtim me Planin Vjetor për furnizim vjetor për vitin 2024 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale nr.05-4729/1 datë 22.12.2023, dhe mjetet janë siguruar nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2024.

Pika 8

Të ndryshme

Nuk ka pasur diskutim nën Të ndryshme.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**